

# FORCIMI I ORGANIZATAVE PARTNERE TË PARTIVE POLITIKE

Vlerësim dhe Perspektivë për Mbështetjen Publike

Raport i hartuar nga eksperti: Neritan Sejamini

Korrik 2024



## Pasqyra e Lëndës

I. KONTEKSTI – FINANCIMET PUBLIKE NË EVROPË DHE SHQIPËRI .....	3
1.    Financimi publik për partitë politike në Evropë .....	3
2.    Financimi publik për partitë në Shqipëri .....	4
3.    Financimi i organizatave rinore .....	5
II.    MODELE FINANCIMI .....	6
1.    Financimi me fonde publike të kushtëzuara për partitë .....	6
1.1 Rasti i Hollandës .....	6
2.    Ndëshkimi apo stimulimi financiar për të rritur përfaqësimin .....	9
3.    Financimi në kuadër të mbështetjes së përgjithshme për organizatat rinore .....	10
3.1 Rasti i Finlandës .....	10
3.2 Rasti i Danimarkës .....	12
4.    Financimi i programeve apo strukturave ombrellë .....	13
4.1 Rasti i EDYN .....	14
III.    KONTEKSTI I ORGANIZATAVE PARTNERE NË SHQIPËRI .....	17
1.    Kapaciteti institucional për menaxhim financiar .....	17
2.    Financimi nga partia .....	17
3.    Financimet private .....	19
4.    Financimi nga anëtarësia .....	20
5.    Financime nga donatorët .....	20
6.    Organizimi dhe marrëdhënia me partinë mëmë .....	21
7.    Organizimi i organizatave partnere në Partinë Socialiste dhe politika e kuotave .....	22
IV.    GJETJE DHE PËRFUNDIME .....	25
Gjetje .....	25
Përfundime .....	26
V.    REKOMANDIME .....	28

## I. KONTEKSTI – FINANCIMET PUBLIKE NË EVROPË DHE SHQIPËRI

### 1. Financimi publik për partitë politike në Evropë

Për të funksionuar partitë politike kanë nevojë për burime financiare. Burimet e brendshme të financimit përbëhen nga kuotat e anëtarësisë, kontributet (një përqindje e caktuar) nga rrogat e përfaqësuesve të partisë të zgjedhur në poste publike, të ardhurat nga aktivitete që organizon partia, të ardhura nga veprimtari që zhvillon partia të cilat krijojnë fitime. Burimet e jashtme përbëhen nga dhurimet private dhe fondet publike.

Në dekadat e fundit, prirja e përgjithshme në Evropë ka qenë ulja e peshës së financimeve të brendshme (veçanërisht ulja drastike e të ardhurave nga pagesat e anëtarësisë), rritja e financimit të jashtëm, veçanërisht të financimeve publike—për shkak të skandaleve korruptive dhe nevojës për të ruajtur pavarësinë nga dhuruesit e mëdhenj dhe shumë vende apo parti kanë kufizuar dhurimet private.

Përdorimi i fondeve publike filloi në Gjermani në vitin 1958 me qëllim garantimin e konkurrencës së barabartë dhe të ndershme. Në dekadën pasardhëse këtë model e përqaftuan Suedia, Finlanda dhe Norvegjia dhe më pas të gjitha vendet europiane. Sot, financimi publik ekziston thuajse në të gjitha vendet europiane.

Fondet e zakonshme vjetore për partitë politike përcaktohen zakonisht si një pjesë fikse e barabartë për çdo parti që plotëson kriteret dhe një pjesë në përpjestim me vendet në parlament apo votat totale të marra nga partitë përkatëse në zgjedhjet e fundit të përgjithshme.

Vlera dhe pesha e financimit publik në totalin e burimeve financiare ka ardhur duke u rritur dhe në shumicën e vendeve të BE-së është burimi kryesor i fondeve për partitë politike (Belgjikë, Danimarkë, Finlandë, Francë, Greqi, Hungari, Irlandë, Islandë, Luksemburg, Norvegji, Sllovaki, Spanjë, Suedi, Poloni, Portugali). Në vende të tjera, përfshi Gjermaninë, ndihma publike është një nga dy burimet kryesore krahas të ardhurave nga pagesat e anëtarësisë dhe në një numër vendesh është burimi i dytë më i madh, pas pagesave të anëtarësisë (Mbretëria e Bashkuar dhe Hollandë).

Financimet publike zënë më shumë se 60 përqind të fondeve totale të financimit të partive politike në BE—në disa vende të BE-së, përfshi Belgjikën, Greqinë, Portugalinë dhe Spanjën, fondet shtetërore zënë mbi 80-90 përqind të fondeve totale të partive politike. Në disa vende financimet e partive janë në fushën e qinda milionë eurove. Për të krijuar një referencë, Gjermania ofron aktualisht rreth 200 milionë euro çdo vit për partitë politike, rreth dy herë më shumë se në vitet 1990-të.<sup>1</sup>

Duhet theksuar se partitë në vendet ish-komuniste të Europës Lindore e Qëndrore (ELQ) janë më të varura nga fondet publike, të cilat zënë mbi 65 përqind të fondeve totale të tyre, se ato në vendet e Evropës perëndimore (rreth 55%). Në vendet ELQ-së, të ardhurat nga

---

<sup>1</sup> Tatiana F Dolgik e të tjerë, Formation of Models for Funding of Political Parties in Europe, (2020). Shiko: <https://www.atlantis-press.com/article/125936276.pdf>

burimet private zënë rreth 11 përqind të të ardhurave totale të partive politike, ndërsa në vendet perendimore pesha e tyre është rreth 14 përqind.<sup>2</sup>

## 2. Financimi publik për partitë në Shqipëri

Formalisht partitë politike shqiptare financohen kryesisht nga fonde publike. Ato përfitojnë çdo vit ndihmë financiare vjetore për mundësimin e veprimtarisë së tyre. Fonde publike përfitojnë a) partitë që kanë përfaqësim parlamentar; b) partitë që kanë më shumë se 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare; dhe c) partitë që në zgjedhjet e fundit parlamentare kanë marrë në total më shumë se 1 përqind të votës popullore.

Mënyra e shpërndarjes së fondeve është përcaktuar në Ligjin për Partitë Politike<sup>3</sup> dhe bëhet me këtë formulë: 70 përqind e fondit total u shpërndahet partive parlamentare në përpjestim me numrin e deputetëve që ka secila; 20 përqind e fondit ndahet në mënyrë të barabartë mes të gjitha partive parlamentare dhe atyre që kanë marrë në total të paktën 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare, pavarësisht nëse kanë deputetë apo jo; dhe pjesa e mbetur prej 10 përqind ndahet në mënyrë të përpjesëshme mes të gjitha partive që në zgjedhjet e fundit parlamentare kanë marrë më shumë se 1 përqind të votës popullore.

Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në vitin 2024 fondi publik për mbështetjen e partive politike është 345 milionë lekë (rreth €3,3 milionë), i shpërndarë mes Partisë Socialiste, rreth 151 milionë lekë; Partisë Demokratike, rreth 106 milionë lekë; Partisë Republikane, rreth 18 milionë lekë; Partisë së Lirisë, rreth 15 milionë lekë, Partisë Social-Demokratike, rreth 12 milionë lekë; dhe LZHK-së, PBDNJ -së dhe PAA-së, secila nga 8 milionë lekë.

Partitë përfitojnë gjithashtu financim të veçantë nga fondet publike për fushatat zgjedhore. Sipas përcaktimit në Ligjin për Partitë Politike, llogaritja e fondit që merr çdo parti bëhet në përpjestim me votat e marra në zgjedhje dhe nga fondi përfitojnë të gjitha partitë që kanë marrë më shumë se 1 përqind e totalit të votave në shkallë vendi. Fondet u jepen paraprakisht partive, në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të mëparshme, por pas përfundimit të zgjedhjeve, partitë ose kthejnë ose kompensohen për diferencën nga totali që u takon në bazë të rezultatit të këtyre zgjedhjeve.

Krahas fondeve publike, partitë në Shqipëri marrin gjithashtu financime private dhuratë. Por një pjesë e madhe e këtyre financimeve bëhet në mënyrë informale dhe me para në dorë, pa u raportuar as si financim dhe as si shpenzim.

Në përgjithësi, transparenca dhe ligjshmëria financimit dhe menaxhimit financiar është një nga problemet kryesore të partive politike në Shqipëri. Një sërë raportimesh dhe analizash, përfshi një hulumtim nga WFD-ja kanë shprehur shqetësimin se shpenzimet e partive

---

<sup>2</sup> European Parliament, Financing of Political Structures in EU Member States. Shiko: [https://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2014\\_2019/plmrep/COMMITTEES/AFCD/DV/2021/10-27/2021-JUNE\\_PE694.836\\_Financingpoliticalstructures\\_withAnnex3\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2014_2019/plmrep/COMMITTEES/AFCD/DV/2021/10-27/2021-JUNE_PE694.836_Financingpoliticalstructures_withAnnex3_EN.pdf)

<sup>3</sup> Shiko: [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Ligji-per-partite-politike-2020\\_1.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Ligji-per-partite-politike-2020_1.pdf)

politike janë më të larta se ato që deklarohen si shpenzime vjetore operacionale, veçanërisht shpenzimet për financimin e fushatave zgjedhore.<sup>4</sup>

### 3. Financimi i organizatave rinore

Në përgjithësi, organizatat partnere të partive në Evropë, përfshi forumet rinore dhe të grave, janë të regjistruara si Organizata Jo Fitimprurëse dhe veprojnë në bazë të legjislacionit për Organizatat Jo Fitimprurëse. Me tej, një pjesë e forumeve rinore janë të përcaktuar edhe si 'organizata rinore', në vende ku ka ligje dhe politika të caktuara rinore që ofrojnë mbështetje për organizatat të përcaktuara si 'organizata rinore'.<sup>5</sup>

Nisur nga ky fakt në një sërë vendesh, organizatat partnere përfitojnë fonde publike jo vetëm përmes linjave partiake por edhe nga fondet publike për shoqërinë civile apo organizatat rinore në veçanti.

Financimet publike janë burimi kryesor i financimit të këtyre organizatave. Ky fakt është rrjedhojë direkte e faktit se partia është burimi kryesor i financimit të organizatave partnere. Partitë politike ose kanë zgjedhur vetë të caktojnë një pjesë të fondeve të tyre vjetore për të mbështetur veprimtarinë e organizatave partnere, ose sikurse shtjellohet më poshtë, në disa vende partitë janë të kushtëzuara me ligj për të transferuar një pjesë të fondeve publike që marrin tek organizatat partnere apo për veprimtari që mbështesin kauzat e këtyre organizatave—kryesisht kushtëzim për financimin e organizatave apo çështjeve të gruas, të rinisë, hulumtimit shkencor, informimit, mbështetjes për partnerë të huaj, etj.

Financat e organizatave partnere raportohen rregullisht dhe auditohen sipas të njejtave kriteret financiare për partitë dhe për financimet publike, në përgjithësi.

Sikurse shtjellohet më poshtë, në Shqipëri nuk ka ndonjë rregull apo kushtëzim për përdorimin e fondeve publike për mbështetjen e organizatave partnere dhe në përgjithësi, këto organizata janë shumë pak të financuara dhe të pambështetura me burime të mjaftueshme për të garantuar veprimtarinë minimale.

---

<sup>4</sup> Mirela Arqimandriti, Achieving Gender Equality in Party Financing in Albania, WFD (2023). Shiko: [https://www.wfd.org/sites/default/files/2023-05/Gender%20equality%20in%20political%20party%20financing\\_Final.pdf](https://www.wfd.org/sites/default/files/2023-05/Gender%20equality%20in%20political%20party%20financing_Final.pdf)

<sup>5</sup> European Parliament, Reviews on Youth Policies and Youth Work in the Countries of South East Europe, Eastern Europe and Caucasus. Shiko: [https://www.youthpolicy.org/uploads/documents/2012\\_Reviews\\_Youth\\_Policies\\_Youth\\_Work\\_South\\_Eastern\\_Europe\\_Summary\\_Report\\_Eng.pdf](https://www.youthpolicy.org/uploads/documents/2012_Reviews_Youth_Policies_Youth_Work_South_Eastern_Europe_Summary_Report_Eng.pdf)

## II. MODELE FINANCIIMI

Më poshtë jepet një përshkrim i përmbledhur i disa modeleve të financimit publik të organizatave partnere të partive politike në Evropë, kryesisht organizatave partiake të rinisë dhe gruas, kryesisht në vendet e Bashkimit Europian (BE-së).

### 1. Financimi me fonde publike të kushtëzuara për partitë

Disa nga vendet evropiane kanë vendosur që një pjesë e fondeve publike për partitë duhet të përdoret prej tyre për të mbështetur përfshirjen në politikë të grupeve të caktuara shoqërore, kryesisht të rinjve dhe grave. Prandaj, ato ua japin partive fondet publike me kushtin që një pjesë të përdoret nga organizatat e tyre partnere.

Kushtëzimi mund të bëhet ose duke e specifikuar pjesën e fondit që kushtëzohet—zakonisht një përqindje e fondit total; ose duke ja lënë në dorë partive të vendosin çfarë pjesë të fondit të përdorin për organizatat partnere apo veprimtari në mbështetje të grave apo të rinjve.

Në të vërtetë kushtëzimi i financimit direkt të organizatave partnerë bëhet kryesisht për organizatat e të rinjve, ose për fundocionet hulumtuese dhe veprimtaritë informuese. Janë të paktën 10 vende të BE-së që në një formë apo tjetër kushtëzojnë direkt mbështetjen financiare të forumeve rinore, përfshi Austrinë, Qipron, Gjermaninë, Hollandën dhe Slloveninë. Rasti më i rëndësishëm në këtë kategori është ai i Hollandës.

#### 1.1 Rasti i Hollandës

Hollanda ishte vendi i parë në Evropë që në vitin 1976, përdori subvencionimin direkt me fonde shtetërore të forumeve rinore partiake.<sup>6</sup> Financimi u prezantua si një projekt i përkohshëm për të hetuar ndikimin e financimit në praktikë, para se të vendosej për ta bërë atë politikë të përhershme. Madhësia e pjesës së financimit publik për çdo forum u vendos në përpjestim me numrin e vendeve në parlament të partisë mëmë. Fondet transferoheshin direkt në llogari të forumit, pa asnjë përfshirje të partisë përkatëse.

Kjo masë solli shpejt rritjen e numrit të forumeve rinore partiake, pasi të gjitha partitë kryesore që nuk kishin forume i krijuan ato. Gjithashtu, u vlerësua menjëherë se ky lloj financimi i forcoi në praktikë forumet rinore si në përmirësimin e veprimtarisë së përgjithshme të tyre por edhe në rritjen e pavarësisë nga partia mëmë, veçanërisht në mbajtjen e qendrimeve kritike ndaj politikave të caktuara të propozuara nga partia.

Që në fillim, qëllimi i këtij programi subvencionimi ishte t'u jepte forumeve rinore më shumë mundësi për të punuar për edukimin dhe formimin politik të të rinjve. Për këtë arsye, pas tre viteve të para, duke filluar nga viti 1980, financimi i forumeve u përqendrua në fonde për mbështetjen e veprimtarive të lidhura me edukimin politik të të rinjve.

---

<sup>6</sup> C. J. de Roone, *The Functioning of Dutch Party Youth Wings: A Comparison of the 1980s and 2010s.*, (2022). Shiko: <https://hdl.handle.net/1887/3480135>

Kurse në vitin 1982, u vendos që subvencionimi të kushtëzohej me aspekte institucionale dhe jo programatike, duke vendosur dy kritere të domosdoshme për të përfituar financimin publik:

- a) forumi duhet të kishte të paktën 1000 anëtarë, të shtrirë në të paktën pesë provinca të vendit; dhe
- b) forumi të njihej formalisht si organizatë partnere nga një prej grupeve parlamentare në parlamentin e Hollandës.

Gjithashtu, u përcaktua se madhësia e subvencionit për çdo forum të llogaritej në bazë të

- a) numrit të anëtareve të forumit; dhe
- b) numrit të deputetëve të grupit që e njihte zyrtarisht forumin.

Ky kushtëzim institucional i detyroi forumet që të regjistronin formalisht anëtarësinë e tyre, krahas hartimit dhe paraqitjes formale të programeve të punës, të cilët duhet të ishin në përputhje me standardet e përcaktuara nga qeveria dhe të synonin forcimin politik të të rinjve. Si rrjedhojë, u rrit në përgjithësi anëtarësia e forumeve rinore.

Krahas këtij subvencionimi të përgjithshëm direkt, forumet rinore kishin të drejtën të aplikonin për të marrë grante për zbatimin e projekteve të veçanta, si çdo organizatë tjetër rinore, veçanërisht për projekte ndërkombëtare, të tilla si forcimi i demokracisë apo zhvillimi i të drejtave të rinisë në vende të tjera të botës.

Në vitin 1990, skema e financimit të forumeve rinore u ripozicionua nga edukimi politik i të rinjve, në një qëllim më të përgjithshëm: rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në politikë. Përgjegjësia e vendimit për caktimin e fondeve iu ngarkua një këshilli të posaçëm i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha forumeve rinore, i cili vepronte nën mbikqyrjen e ministrisë përgjegjëse për subvencionimin e forumeve rinore.

Në vitin 1999 (përmirësuar më 2013), skema e financimit të forumeve rinore mori strukturën që ka edhe sot: fondi për organizatat rinore partiake përcaktohet si pjesë e kushtëzuar e fondit total shtetëror që jepet çdo vit për çdo parti politike. Ky përcaktim është sanksionuar në ligjin e partive politike. Ligji përcakton se çdo parti e përfaqësuar në parlament, të cilat marrin grante nga shteti, ka të drejtën të caktojë një organizatë rinore si organizatë partnere të saj, për të cilën ajo mund të marrë financim shtetëror. Në fondin që i jepet partisë politike shënohet një shumë e caktuar për subvencionimin e veprimtarisë së forumit të saj rinor.

Hollanda mbështet me ndihmë vjetore të gjitha partitë politike që kanë prani parlamentare. Fondit për çdo parti përbëhet nga një shumë fikse e barabartë për të gjitha partitë; një shumë e përpjesëshme me numrin e vendeve në parlament të partisë; dhe një shumë tjetër në përpjestim me numrin e anëtarëve të partisë. Kur partitë deklarojnë zyrtarisht një organizatë rinore partnere, atyre ju jepet fond shtesë, mbi atë të përcaktuar si më sipër, i cili është i kushtëzuar t'i kalojë organizatës rinore.

Si për të gjitha organizatat partnere, edhe pse shuma për forumin rinor llogaritet si pjesë e subvencionit të partisë politike, fondi transferohet direkt nga buxheti shtetëror në llogarinë e

forumit përkatës. Forumit rinor nuk i lejohet që të kalojë pjesë të kësaj shume tek partia mëmë apo institucione të tjera partnere apo të lidhura me partinë. Fondi duhet të përdoret ekskluzivisht nga forumi në bazë të një programi për fuqizimin e pjesëmarrjes në politikë të anëtarëve të forumit dhe rinisë në përgjithësi.

Ligji ka vendosur një sërë kriteresh që forumi rinor të marrë financim shtetëror, përmes partisë përkatëse:

- a) Forumi duhet të jetë një organizatë që zhvillon ekskluzivisht ose kryesisht veprimtari për nxitjen e pjesëmarrjes politike të të rinjve.
- b) Forumi ka të paktën 100 anëtarë midis moshës 14 dhe 27 vjeç, të cilët kanë paguar kuotën e anëtarësisë prej 5 euro në vit.
- c) Forumi ka një anëtarësi që përbëhet të paktën në masën 2/3 nga të rinjtë e përshkruar në pikën 2) më sipër.
- d) Forumi pranon me shkrim partneritetin me partinë mëmë.

Madhësia e fondit që përfiton çdo forum rinor përcaktohet në bazë të dy kriterëve:

- a) Numrit e vendeve në parlament partisë mëmë.
- b) Numrin e anëtarëve të forumit rinor.

Ligji nuk bën dallim midis anëtarit të forumit dhe anëtarit të partisë, që do të thotë se të gjithë personat që janë anëtar partie dhe njëkohësisht anëtarë të forumit llogariten dy herë: edhe në llogaritjen e fondit që i shkon partisë, edhe në llogaritjen e fondit që i shkon forumit. Kjo ka shtyrë partitë që të nxisin anëtarësimin në parti të anëtarëve të forumit jo vetëm duke shtuar vëmendjen e partisë ndaj forumit dhe anëtarësisë së tij, por edhe duke u dhënë anëtarëve të forumit qasje në veprimtarinë e partisë.

Në fakt, një nga arritjet apo përfitimet më të mëdha të këtij sistemi të financimit partiak dhe të forumeve rinore është pikërisht nxitja e partive në veprime për të rritur numrin e anëtarëve dhe për të mobilizuar anëtarësinë. Në kushtet kur anëtarësimi në parti ka rënë në shumë vende evropiane dhe kur ka një zhgënjim të përhapur me partitë në përgjithësi, ky stimul arrin të moderojë deri diku efektet e kësaj krize.

Në një vështrim më të gjërë, një sërë analizash kanë nxjerrë në pah se skema hollandeze e subvencionimit të forumeve rinore ka sjellë disa rezultate pozitive. Në rradhë të parë ajo nxitur krijimin e forumeve rinore pranë të gjitha partitë hollandeze. Ajo ka nxitur përpjekjet për rritjen e anëtarësisë së forumeve dhe ka rritur transparencën në lidhje më këtë anëtarësi. Gjithashtu, ka rritur përgjegjësinë e anëtarëve të forumit, duke qenë se ata detyrohen të paguajnë kuotën e antarësimit, ndonëse në një shumë të vogël.

Skema ka përmirësuar veprimtaritë e forumeve për rritjen e kapaciteteve dhe formimin politik të të rinjve dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në politikë. Mbi të gjitha, ka siguruar një pavarësi të shëndetshme nga partia mëmë, duke garantuar pavarësinë financiare, e cila çon në pavarësi më të gjërë, përfshi qendrimet kritike politike dhe rritjen e ndikimit në formësimin e politikave të partisë.



## 2. Ndëshkimi apo stimulimi financiar për të rritur përfaqësimin

Në lidhje me gratë, kushtëzimi direkt i fondeve partiake është praktikë më e rrallë—rasti më tipik ka qenë ai i Italisë deri para pak kohe e cila kërkonte që që 5 përqind e fondeve publike për partinë t'i kalohehin organizatave partiake të gruas.

Praktika evropiane për mbështetjen e grave ka evoluar drejt nxitje së përfaqësimit direkt të grave në politikë—çfarë është edhe qëllimi kryesor forumeve partiake të grave. Mbi 30 vende evropiane kushtëzojnë fondet partiake fondet publike përpartitë me kandidimin e grave në zgjedhje parlamentare apo vendore, apo me zgjedhjen e tyre në parlament, pushtetin vendor apo në në organe të larta shtetërore. Disa nga vendet kryesore me kushtëzime të tilla janë: Kroacia, Finlanda, Franca, Irlanda, Portugalia dhe Rumania.<sup>7</sup>

Dy vendet me kushtëzimin më të rreptë janë Irlanda dhe Portugalia, të cilat zbatojnë sanksione të rënda për partitë që nuk arrijnë standarde të caktuara të kandidimit të grave.<sup>8</sup> Në Irlandë, nëse një parti nuk i vendos gra (apo burra) të paktën 40 përqind të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare, ajo humbet gjysmën e financimit publik që do i takonte çdo vit, deri në zgjedhjet e ardhshme.

Në mënyrë të ngjashme, Portugalia ndëshkon me zvogëlim në masën prej një të katërtës së fondeve publike, nëse një nga gjinitë është e përfaqësuar në më pak se një të tretën në listat e kandidatëve në zgjedhjet parlamentare—zbritja bëhet sa një e dyta e financimit vjetor nëse një nga gjinitë përfaqësohet më pak se 10 përqind në listat e kandidatëve. Franca është një tjetër rast i gjithashtu zbaton masa ndëshkimore me uljen e fondit publik nëse ka hendek në përfaqësimin gjinor.<sup>9</sup>

Në përgjithësi, kushtëzimi i fondeve me përmbyshjen e kuotave gjinore të përcaktuara me ligj ka arritur rezultate të mira në rritjen e pjesëmarrjes së grave në parlament dhe në përgjithësi në drejtimin e lartë politik. Kjo mbetet një formë e preferuar e nxitjes së gruas në karrierë nga partitë politike. Në mënyrë të veçantë, sikurse thekson një analizë e organizatës IDEA, ulja e fondeve apo gjobat kanë efikasitet në ato raste kur fonde publike janë më të mëdha krahasur me ato private, që në fakt është rasti i thuajse të gjitha vendeve të BE-së.

Megjithatë, edhe vende si Shqipëria, ku zbatohen gjoba të vogla për partitë që nuk plotësojnë kuotën e përcaktuar me ligj—kushtin që një në çdo tre kandidatë në listat partiake zgjedhore të jetë grua—rezultatet për nxitjen e grave janë të ndjeshme, 50 nga 140 deputetët (36 përqind) të Kuvendit të Shqipërisë janë aktualisht gra.

Një tjetër formë e kushtëzimit të fondeve publike për të siguruar dhe nxitur përfaqësimin e grave është përdorimi i stimujve progresivë financiarë për të shpërblyer nivelet të ndryshme të përfaqësimit të grave. Pra në vend të ndëshkimit për mospërmbyshje të kuotave të

<sup>7</sup> Fernando Casal Bértoa dhe Juan Rodríguez Teruel, Political Party Funding Regulation in Europe, East and West: A Comparative Analysis. Shiko: <https://www.osce.org/files/osce-odihr%20discussion%20paper%20on%20political%20party%20finance%20spain.pdf>

<sup>8</sup> European Parliament, Party Financing and Referendum Campaigns in EU Member States, 2015

<sup>9</sup> The International IDEA, Inter-Parliamentary Union and Stockholm University, Global Database of Quotas for Women. Shiko: <http://www.quotaproject.org/>

vendosur me ligj, përdoret shpërblimi financiar për t'i motivuar vetë partitë t'u japin prioritet grave në përfaqësim.

Vendet kryesore që e përdorin këtë model janë Gjeorgjia, Kroacia dhe Rumania. Në këto vende partitë marrin fonde shtesë për kandidimin e grave në listat zgjedhore. Në Gjeorgji, partitë marrin një shtesë prej 10 përqind mbi fondet vjetore nëse në zgjedhjet e fundit parlamentare kishin të paktën 20 përqind të kandidatëve gra në listat zgjedhore.

Në Kroaci, partitë parlamentare marrin 10 përqind shtesë fondi për çdo kandidat të zgjedhur në parlament që i përket gjinisë së nënpërfaqësuar, që historikisht vazhdojnë të jenë gratë. Moldavia gjithashtu zbaton një skemë minimale nxitëse për përfshirjen e grave në lista zgjedhore.

Është e qartë se sa më i madh të jetë stimuli monetar, aq më i madh motivimi për të përfshirë gratë në përfaqësim. Analizat e vendeve që përdorin stimuj të tillë, tregojnë se përfaqësimi më i lartë i grave, si në kandidim ashtu edhe në sigurimin e vendeve në parlament, arrihet kur stimujt kushtëzohen me vendet në parlament krahasuar me kushtëzimin e vendeve në listat e kandidatëve zgjedhorë.

### **3. Financimi në kuadër të mbështetjes së përgjithshme për organizatat rinore**

Në disa vende evropiane, forumet rinore përfitojnë nga fondet e përgjithshme për shoqërinë civile. Në mënyrë të vecantë, disa vende i trajtojnë forumet partiake rinore si çdo organizatë tjetër rinore dhe u japin atyre të njëjtën qasje në fondet publike si organizatat e rinore që i përkasin shoqërisë civile, duke i trajtuar si aktorë të domosdoshëm në përmbushjen e programeve dhe politikave kombëtare rinore. Finlanda është një nga vendet më të suksesshme në zbatimin e këtij modeli të financimit të organizatave rinore partiake.

#### **3.1 Rasti i Finlandës**

Në Finlandë, organizatat rinore politike, përfshi forumet rinore partiake, kanë të drejtën të përfitojnë financim publik si pjesë e mbështetjes shtetërore për rininë.

Finlanda i mbështet të gjitha organizatat rinore në bazë të Ligjit të Rinisë. Mbështetja u jepet të gjitha organizatat jofitimprurëse që punojnë me të rinjtë në zbatim të politikave kombëtare për rininë. Këto politika rinore mbështesin veprimtari të larmishme në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të të rinjve, të përfshirjes shoqërore dhe rritjes së ndikimit të tyre në shoqëri, në rritjen e pavarësisë së tyre dhe në përgjithësi përmirësimin e jetesës së të rinjve.<sup>10</sup>

Ligji e përcakton qartësisht se të gjitha organizatat që njihen formalisht si organizata kombëtare rinore kanë të drejtë të përfitojnë subvencione shtetërore. Ligji njih si organizata të tilla të gjitha organizatat që punojnë me rininë apo zhvillojnë veprimtari me përfitues të

---

<sup>10</sup> Finland's Youth Act. Shiko: <https://okm.fi/documents/1410845/4276311/Youth+Act+2017/c9416321-15d7-4a32-b29a-314ce961bf06/Youth+Act+2017.pdf?t=1503558225000>

rinjtë. Ligji e shpreh në mënyrë direkte se organizata të tilla janë edhe të gjitha organizatat ideologjike dhe politike që veprojnë në fushën e rinisë.

Për këtë qëllim, qeveria finlandeze, përmes Ministrisë e Arsimit dhe Kulturës, financo veprimtarinë e përgjithshme të organizatave rinore, duke u akorduar çdo vit fonde që organizatat mund t'i përdorin për të veprimtarinë e tyre operacionale apo programatike—fondet janë të pakushtëzuara dhe mund të përdoren për çfarëdo qëllimi që organizata zgjedhin. Edhe forumet rinore partiake kanë të drejtë të aplikojnë dhe përfitojnë çdo vit një fond të pakushtëzuar për të financuar aktivitetin e tyre, sipas mënyrës që e gjykojnë të arsyeshme.

Këto fonde janë burimi kryesor i financimit të aktivitetit të përditshëm dhe veprimtarive të tjera të forumeve rinore partiake. Finlanda nuk ofron mbështetje të posaçme për forumet rinore partiake dhe forumet rinore nuk përfshihen në mënyrë taksative në ndihmën shtetërore që u jepet partive politike, ndonëse Finlanda është një nga vendet me bujare për subvencionimin publik të partive politike.

Të gjitha partitë parlamentare marrin fonde publike në përpjestim me vendet në parlament; ndërsa partitë e papërfaqësuar në parlament, por që kanë marrë të paktën 2 përqind të votës popullore në zgjedhje parlamentare, marrin sa një e treta e financimit që marrin partitë parlamentare për çdo mandat parlamentar. Nga ana tjetër, grupet parlamentare marrin mbështetje nga buxheti i parlamentit, e cila përbëhet nga një pjesë fikse e barabartë për të gjitha grupet dhe një pjesë në përpjestim me numrin e anëtarëve të grupit parlamentar.<sup>11</sup>

Për të garantuar një shumë të qendrueshme dhe të bollshme për mbështetjen e rinisë, përveç fondeve të tjera shtetërore që caktohen për rininë, Finlanda ka sanksionuar me ligj që të gjitha fitimet e Llotarisë Kombëtare Finlandeze, e cila administrohet nga shteti, shkojnë për mbështetjen e artit, sportit, kulturës dhe rinisë.

Një pjesë e fondeve të destinuara për mbështetjen e rinisë menaxhohet nga agjencitë qendore, përfshi Ministrinë e Kulturës dhe Arsimit, por një pjesë e tyre, i transferohet pushtetit lokal (rajoneve dhe bashkive), të cilat gjithashtu financojnë projekte lokale rinore nga organizatat rinore. Degët lokale të forumeve rinore partiake mund të aplikojnë dhe përfitojnë edhe nga këto fonde lokale, krahas financimit që marrin nga fondet qendrore.<sup>12</sup>

Mbështetja që u jepet organizatave rinore është në dy plane:

- a) mbështetje institucionale për veprimtarinë e përgjithshme të organizatës; dhe
- b) mbështetje për projekte konkrete.

Mbështetja institucionale, ose siç njihet mbështetja e përgjithshme, është mbështetja kryesore shtetërore që përfitojnë organizatat rinore, përfshi forumet rinore. Kjo lloj mbështetje është pjesë thelbësore e zbatimit të Ligjit të Rinisë, sepse garanton aftësinë organizative

---

<sup>11</sup> European Parliament, Financing of Political Structures in EU Member States.

<sup>12</sup> Council of Europe, Youth Policy In Finland. Shiko: <https://rm.coe.int/16807023f4>

dhe vepruese të organizatave rinore kombëtare, të cilat janë agjentët që zbatojnë politikat rinore dhe mbështetjen e rinisë.

Për të marrë subvencionim me ndihmë të përgjithshme, organizatat aplikojnë duke paraqitur programin vjetor të veprimtarive, të cilat duhet të jenë në përputhje me objektivat kombëtare të punës rinore. Që të aplikojnë çdo organizatë duhet:

- a) të ketë zhvilluar veprimtari të pranueshme shoqërore, të shtrirë në nivel kombëtar;
- b) të ketë të paktën 1 mijë anëtarë, dy te tretat e të cilëve duhet të jenë nën 29 vjeç; dhe
- c) të ketë burime të tjera financimi.

Nëse plotësohen kushtet ligjore dhe programi i propozuar përputhet me politikat kombëtare rinore, organizatës i akordohet granti në një masë që vlerësohet e nevojshme.

Veprimtaria e organizatës monitorohet në mënyrë që financimi të përdoret vetëm për qëllimet për të cilat është miratuar, si dhe vlerësohet për arritjen e rezultateve dhe cilësinë e tyre, çfarë shërben si kriter për vlerësimin e saj në vitin pasardhës.

Për ilustrim, në vitin 2021, nga mbështetja shtetërore përfituan mbi 100 organizata me një buxhet total mbi 19 milionë euro. Ndërsa për vitin 2023, fondi total për të mbështetur zbatimin e politikave rinore ishte mbi 60 milionë euro, nga të cilat rreth 30 për qind shkuan direkt si subvencionim për organizatat rinore.<sup>13</sup>

Fondet që përfiton çdo forum rinor partiak në vit janë në nivelin e disa qindra mijëra eurove.

Aplikimet shqyrtohen nga një organizëm i veçantë, Komisioni i Vlerësimit dhe Nidhmës Shtetërore që është përgjegjës për shpërndarjen e subvencioneve shtetërore për rininë. Komisioni ia përcjell propozimet për financim Ministrisë së Kulturës dhe Arsimit, e cila bën miratimin e fondit për çdo organizatë. Anëtarët e komisionit emërohen nga qeveria në bazë të propozimeve që vinë nga përfaqësuesit e organizatave rinore dhe janë ekspertë të rinisë dhe veprimtarive rinore.

Ky model i financimit të forumeve rinore partiake nuk gjendet vetëm në Finlandë. Një skemë e ngjashme përdoret edhe nga Danimarka dhe Norvegjia.

### 3.2 Rasti i Danimarkës

Danimarka përdor një skemë të ngjashme: i financon forumet rinore si pjesë e mbështetjes qeveritare apo subvencionimit të organizatave rinore apo organizatave që bëjnë punë me rininë. Financimi ofrohet në të gjitha nivelet—qendror, rajonal dhe bashkiak—dhe fondet shpërndahen nga qeveria qendrore apo vendore në bazë të programeve të propozura dhe objektivave shtetërore për rininë.

Edhe në rastin e Danimarkës një pjesë e financimit për rininë vjen nga fitimet e llotarisë kombëtare. Në mënyrë të ngjashme, forumet rinore përfitojnë grante për subvencionimin e

---

<sup>13</sup> Të dhënat e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës së Finlandës. Shiko: <https://okm.fi/en/financing-youth>

veprimtarisë së tyre, pra grante institucionale, por kanë të drejtë të aplikojnë dhe përfitojnë edhe financime për projekte konkrete në mbështetje të rinisë.<sup>14</sup>

Ky model, që mund të quhet nordik, ka rezultuar i suksesshëm për fuqizimin e forumeve rinore partiake. Ai siguron mbështetje të mjaftueshme për veprimtarinë e përditshme të forumeve partiake, por edhe për financimin e aktiviteteve për aftësimin, edukimin dhe zhvillimin e të rinjve si dhe pjesëmarrjen e tyre në politike.

Mbi të gjitha, kjo skemë ka rritur ndjeshëm pavarësinë e forumeve rinore nga partitë mëmë, duke qenë se ato nuk janë të varura nga partia për financim.

Kjo skemë ka bërë gjithashtu që planet e aktiviteteve të forumeve të përputhen më shumë me interesat rinore dhe të anëtarësisë së forumeve se sa me interesat strikte partiake – për shkak se për të marrë financim forumet duhet të hartojnë paraprakisht plane që përputhen jo vetëm me standardet etike dhe politike por edhe me prioritet kombëtare shtetërore për rininë.

Një nga përfitimet e këtij modeli është shmangia e rrëshqitjes së forumeve në ideologji apo qëndrime ekstreme, pasi kështu do të humbisnin financimin publik, duke venë në rrezik funksionimin dhe veprimtarinë e tyre. Në të shkuarën, ka patur disa raste të tilla, kur forumet rinore partiake kanë humbur financimin vjetor për shkak të pohimeve apo qëndrimeve raciste, çfarë ka zbutur qëndrimet e tyre në të ardhmen.<sup>15</sup>

#### **4. Financimi i programeve apo strukturave ombrellë**

Një praktikë më pak e përhapur për financimin e organizatave partnere, veçanërisht forumeve rinore, është financimi i tyre indirekt përmes financimit të koalicioneve apo organizimeve të përbashkta të organizatave partnere të disa apo të gjitha partive, pra të veprimtarisë së përbashkët ndërpartiake të forumeve. Këto organizime janë më tipike për forumet rinore.

Organizime të tilla ombrellë mbarëpartiake apo shumëpartiake punojnë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta në interes të rinisë në përgjithësi, përtej bindjeve dhe linjave politike, duke bashkërenduar financimet dhe përpjekjet e tyre. Ato mundësohen nga një fakt i thjeshtë: pavarësisht dallimeve ideologjike dhe interesave konkurruese partiake, një nga qëllimet kryesore të forumeve rinore është edukimi politik i të rinjve, aftësimi i tyre, dhe krijimi i lidhjeve dhe rrjeteve të bashkëpunimit mes tyre.

Këto qëllime mund të arrihen edhe në organizme apo struktura ndërpartiake, të cilat kanë një sërë avantazhesh, përfshi efektivitet nën kosto, mundësi për të garantuar cilësi më të lartë dhe lehtësi organizative dhe menaxhimi.

Një rast tipik i një organizimi të tillë është rrjeti European Democracy Youth Network—EDYN.

---

<sup>14</sup> Youth Wiki, European Commission, Youth policies in Denmark, (2019). Shiko: [https://national-policies.eacea.ec.europa.eu/sites/default/files/2021-06/Denmark\\_2019.pdf](https://national-policies.eacea.ec.europa.eu/sites/default/files/2021-06/Denmark_2019.pdf)

<sup>15</sup> Yle News, Finns Party Youth Wing Denied State Funding After Racist Tweet. Shiko: <https://yle.fi/a/3-10840155>

## 4.1 Rasti i EDYN

EDYN<sup>16</sup> është një organizatë e pavarur jofitimprurëse e themeluar në vitin 2018 me qëllim për të nxitur frymën demokratike dhe kulturën e bashkëpunimit politik mes të rinjve me interesa politike në vendet që dikur ishin pjesë e bllokut komunist.

Organizata u themelua nga dy institutet partiake amerikane, International Republican Institute (IRI), fondacioni ndërkombëtar i Partisë Republikane amerikane dhe National Democratic Institute (NDI) fondacioni ndërkombëtar i Partisë Demokratike amerikane, me financim të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA-ve (USAID).

EDYN e ka qendrën ekzekutive në Bratislavë të Sllovakisë dhe ka kapituj lokalë në 23 vende të Evropës dhe Euroazisë.<sup>17</sup> Aktualisht, rrjeti përmbledh 230 udhëheqës të rinj, pjesa dërrmuese e të cilëve janë pjesëtarë të dalluar të forumeve rinore partiake të vendeve përkatëse, por edhe individë të spikatur të organizatave të tjera rinore.

Qëllimi i rrjetit është që të kundërveprojë ndaj polarizimit politik dhe politikës konfliktuale, të formojë një brez të ri udhëheqësish të brymosur me vlerat themelore të lirisë dhe demokracisë dhe të ndryshojë kulturën politike në vendet ku ende ka një trashëgimi të mëndësisë autokratike politike.

Secili nga kapitujt lokalë ka organizim dhe menaxhim të pavarur dhe në to bëjnë pjesë anëtarë të forumeve kryesore rinore partiake të vendit përkatës. Kapitulli drejtohet nga udhëheqësit e zgjedhur me votim të gjithë anëtarëve të kapitullit. Udhëheqja përbëhet nga një president dhe këshill që luajnë rolin ekzekutiv të menaxhimit të kapitullit dhe nga një numër 'ambasadorësh', të cilët janë përgjegjës për hartimin, planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të organizatës.

Çdo kapitull lokal është i pavarur në veprimtarinë dhe aktivitetet që organizon, me kusht që të koordinohet dhe bashkërendojë me të gjithë rrjetin. Kapitujt marrin pjesë edhe në aktivitetet dhe projektet ndërvendase, përfshi trajnime ndërkombëtare, shkëmbime përvoja, apo konferenca rajonale.

Anëtarët kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha veprimtaritë e organizatës, si dhe të propozojnë projekte individuale apo në grup, nga të cilat përzgjidhen ato që do të financohen nga EDYN.

Aktivitetet kryesore të kapitujve lokalë janë trajnime, seminare dhe konferenca për aftësimin e formimin e anëtarëve dhe forcimin e lidhjeve mes tyre; ndërsa në nivelin rajonal, pjesëtarë të kapitujve të ndryshëm hartojnë dhe zbatojnë projekte të përbashkëta që financohen me minigrante nga fondet e vetë EDYN. Në nivel rajonal apo të mbarë rrjetit, anëtarët marrin pjesë në konferenca dhe aktivitete të përbashkëta.

---

<sup>16</sup> Shiko: <https://edyn.eu>

<sup>17</sup> Vendet anëtare janë: Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Kroacia, Bosnja Hercegovina, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Moldavia, Çekia, Sllovakia, Polonia, Hungaria, Estonia, Letonia, Lituania, Bjellorusia, Ukraina, Gjeorgjia, Armenia dhe Azerbajxhani.

Disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë janë:

- një mekanizëm mini-grantesh për të mbështetur projektet që projektohen dhe zbatohen nga vetë anëtarët;
- aktivitete për krijimin e aftësive praktike në një sërë fushash, përfshi menaxhim fushatash, ngritje fondesh, komunikim publik, menaxhim rrjetesh sociale, etj.
- marrje përvojë ose shkëmbim idesh me personalitete të identifikuar nga vetë anëtarët;
- programe të përshtatura mentorimi për zhvillimin personal.

Ekipi qendror i EDYN-it është përgjegjës për ngritjen e fondeve për të gjithë organizatën, ndërkohë që çdo kapitull lokal mund të ngrejë fonde në vendet e tyre.

Përveç donatorëve dhe partnerëve të qendrueshëm, mbi të gjitha NDI-së dhe IRI-së, EDYN-i ka arritur të ngrejë fonde nga burime dhe donatorë të tjerë përfshi BE-në, NATO-n, qeverinë britanike, Qendrën Martens, Fondacionin Konrad Adenauer, etj.

Për ilustrim, pak ditë më parë EDYN fitoi dy grante nga Komisioni Evropian për një shumë totale mbi 600 mijë euro. Këto fonde, si dhe të gjithë të tjerët të siguruara si rrjet ndërkombëtar, shpërndahen mes kapitujve lokalë, të cilët do t'i vet-menaxhojnë për përmbushjen e aktiviteteve, për trajnim dhe aftësimin e anëtarëve dhe për mbështetjen e propozimeve të tyre për mini-projekte në fusha të ndryshme. Këto fonde dhe aktivitete në nivel fundor, kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve njerëzore të forumeve rinore partiake që kanë anëtarë të tyre në EDYN. Me shtimin e fondeve të EDYN, shtohen edhe anëtarët e kapitujve lokalë. Aktualisht kapitulli shqiptar ka rreth 75 anëtarë, të gjithë përfaqësues të forumeve rinore të PS-së, PD-së, LRI (PL)-së dhe grupimit Basha.

Pavarësisht, veçantive të organizimit dhe financimit, modeli i EDYN ka dëshmuar një sërë avantazhesh të cilat mund të përfitohen nëse krijohen forma apo organizime të ngjashme mes forume rinore në Shqipëri.

Një organizim i tillë krijon forcë apo ndikim më të madh për të mbledhur fonde apo siguruar financim indirekt për veprimtari të formimit, edukimit, dhe advokacisë së rinisë. Një organizim i tillë ndërpartiak mund të sigurojë akses në fonde dhe burime që janë të vështira për forume partiake të veçanta, të cilët ndër të tjera mund të konsiderohen të njëanshëm dhe me fokus të ngushtë publik. Burime të tilla që mund të bëhen të aksesueshëm përmes organizimeve ndërpartiake janë veçanërisht mhs donatorët e mëdhenj si Komisioni Evropian apo qeveri të ndryshme të BE-së që ofrojnë programe ndihmë për Shqipërinë.

Nga ana tjetër një organizim i tillë ofron një mundësi të mirë për të bashkuar financime nga donatorë të ndryshëm, për të bashkëfinancuar veprimtari me interes të përbashkët, duke zgjeruar ndikimin e këtyre aktiviteteve; duke ulur koston totale të aktiviteteve dhe duke përmirësuar efikasitetin dhe mirëpërdorimin e fondeve; si dhe duke përmirësuar cilësinë e aktiviteteve përfshi rekrutimin e ekspertëve, trajnuesve, mentorëve dhe personalitetëve më të shquara.

Një organizim i tillë ofron dimensione të reja në veprimtarinë rinore të të rinjve me interesa dhe angazhim partiak, pasi nxit e kultivon një frymë tolerance dhe bashkëpunimi mes individëve me bindje dhe përkatësi të ndryshme politike, forcon identitetin kombëtar dhe vlerat shoqërore.

Disa forma të tilla të suksesshme të organizatave ombrellë ekzistojnë aktualisht në Shqipëri, por janë të profilit jo politik. Mes tyre, mund të përmendet Kongresi Rinor Kombëtar, një organizatë ombrellë e rreth 120 organizatave rinore, që ka ndërmarrë projekte madhore dhe ka tërhequr fonde nga donatorë të mëdhenj.

Në Kuvendin e Shqipërisë ekziston një grupim i grave deputeteve ku janë përfshirë deputete nga të gjitha forcat politike, me qëllim bashkërendimin e punës për mbështetjen e interesave të grave përtej ngjyrimeve partiake (Aleanca e Grave Deputete).

Nga ana tjetër një sërë donatorësh kanë provuar me sukses organizimin e veprimtarive që përfshijnë përfaqësues nga forume rinore apo të grave të partive kryesore, nga i gjithë spektri politik. WFD, Fondacionet Konrad Adenauer dhe Friedrich Ebert, institutet NDI dhe IRI, Fondacioni Shoqëria e Hapur, kanë përvojë pozitive në organizimin e veprimtarive ku kanë bashkuar përfaqësues të forumeve rinore apo të gruas dhe në disa raste duke bashkëfinancuar këto aktivitete.

Me vullnetin apo nxitjen e donatorëve, mund të jetë e mundur krijimi i një strukture ombrellë të forumeve rinore partiake, në rastin më të thjeshtë, një këshill koordinues dhe në rastin më të ndërlikuar, një strukturë e përhershme ndërpartiake trajnimi dhe aftësimi të të rinjve.



### III. KONTEKSTI I ORGANIZATAVE PARTNERE NË SHQIPËRI

#### 1. Kapaciteti institucional për menaxhim financiar

Financimi i organizatave partnere nuk mund të kuptohet i shkëputur nga kushtet institucionale dhe organizimi i organizatave partnere. Njësoj, përmirësimi i financimit dhe pavarësisë financiare të këtyre organizatave është kërkon si kusht përmirësimin institucional dhe organizativ të tyre.

Duhet theksuar që në krye se forumet rinore dhe te gruas të tre partive kryesore politike funksionojnë si organizime të brendshme vullnetare partiake, pa personalitet juridik dhe institucional.<sup>18</sup>

Asnjë prej tyre nuk është i regjistruar në gjykatë si shoqatë në bazë të ligjit të Organizatave Jo Fitimprurëse, i cili është kuadri ligjor i detyrueshëm për formalizimin ligjor të tyre. Për këtë arsye, asnjë nga forumet nuk ka personalitet juridik dhe nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me palë të tjera.

Për rrjedhojë, asnjë nga forumet nuk ka dhe nuk mund të hapë llogari të veten bankare—hapja e llogarisë bankare kushtëzohet me qënien person juridik. Nga ana tjetër, asnjë forum nuk është pajisur me nënlllogari bankare në llogaritë e partisë, apo me llogari të dedikuar për ta edhe pse formalisht në emër të partisë mëmë—çfarë do ishte një mënyrë e tërthortë për të mundësuar marrjen direkte të fondeve dhe për rrjedhojë vetëadministrimin e tyre, përveç PL që është në process me forumin rinor dhe atë të gruas.

Për shkak të mos qënies person juridik, asnjë forum nuk është i regjistruar në organet tatimore.

Mangësitë e mësipërme—mos qenia person juridik, mospasja e llogarive bankare dhe mosregjistrimi në organet tatimore —e bën të pamundur që forumet e partive kryesore të zhvillojnë veprimtari formale financiar, duke qenë se ligjërisht ato nuk mund të marrin fonde dhe nuk mund të zhvillojnë marrëdhënie financiare-ekonomike.

Ky fakt do të thotë se se asnjë nga forumet nuk zhvillon veprimtari formale dhe legjitime financiare. Mënyra si ata veprojnë në këto kushte është:

- a) Pjesërisht veprimtaria e tyre menaxhohet financiarisht nga partia përkatëse;
- b) Pjesa veprimtarisë së tyre zhvillohet informalisht nga ana financiare, me veprime me para në dorë, të cilat nuk regjistrohen dhe nuk raportohen.

#### 2. Financimi nga partia

Partitë shprehen se nuk kanë burime të mjaftueshme për të përcaktuar një buxhet të posaçëm për forumet rinore dhe të gruas. Në fakt asnjë parti nuk ka ndonjë mekanizëm të qendrueshëm të financimit të organizatave partnere; asnjë nuk harton buxhet vjetor financiar

---

<sup>18</sup> Informacioni për këtë përshkrim është marrë nga intervistat me përfaqësuesit e forumeve dhe të partive dhe nga rishikimi i dokumenteve formale të partive dhe forumeve, përfshi statutet përkatëse.

ku të përfshihet edhe buxheti për organizatat partnere; asnjë nuk cakton apo planifikon ndonjë fond total vjetor që i transferohet apo i lihet në përdorim forumeve.

Partia e Lirisë është e vëmtejta që e ka të përcaktuar në Statut së fundmi se buxheti i forumit rinor dhe të gruas përfshihen në buxhetin vjetor të partisë, por ky përcaktim duhet parë si zbatohet në praktikë —Partia e Lirisë nuk planifikon dhe nuk transferon tek forumet e saj buxhet apo fond vjetor deri tani.

Pavarësisht mungesës së financimit të qendrueshëm, të tre partitë raportojnë se japin mbështetje për forumet respective, duke mbuluar shpenzimet për veprimtarinë më të rëndësishme të tyre.

Të tre partitë ofrojnë infrastrukturë minimale për veprimtarinë e përditshme të forumeve. Të gjitha i kanë vënë në përdorim forumeve përkatëse një hapësirë zyre në selinë qendrore dhe mbulojnë shpenzimet që lidhen me mirëmbajtjen dhe funksionimin e zyrës. Gjithashtu, forumeve u vihen në dispozicion, herë pas here, mjediset e selive qendrore apo të zyrave në degë për takime, mbledhje e veprimtari të tjera të tyre.

Forumeve u është mundësuar, gjithashtu, qasja në infrastrukturën e partisë, të tilla si rrjetet IT, qasja në internet, ruajtje e të dhënave, etj. Në disa raste, partitë mbulojnë koston e transportit apo qëndrimit të drejtuesve të forumit gjatë udhëtimeve të tyre nëpër vende të ndryshme në Shqipëri.

Nga intervistat me përfaqësuesit e forumeve është e qartë se, përveç mbështetjes me zyra, financimi i partive për to është i paqendrueshëm—financimi apo mbështetja për veprimtarinë e tyre vlerësohet e vendoset rast pas rasti. Për më tepër, në përgjithësi mbështetja jepet në formë indirekte: partia paguan direkt, përmes financierëve ose personave përgjegjës për financat partiake dhe përmes llogarive të saj, shpenzimet apo kostot e veprimtarive apo të mallrave e shërbimeve që sigurohen nga forumi.

Nga ana tjetër, anëtarët e forumeve përfshihen herë pas herë në veprimtaritë të organizuara nga partia, veçanërisht në trajnime, konferenca, shkëmbim përvoja, etj. duke mbuluar pjesërisht një pjesë të veprimtarisë në këtë drejtim të forumeve.

Duhet theksuar, së fundmi, se në një masë të madhe, aktiviteti financiar i partive bëhet në mënyrë informale, pa raportuar as burimin e financimit dhe as shpenzimet, dhe me transaksione me para në dorë. Për këtë arsye, një pjesë e financimeve nga partia për veprimtari të forumeve ndodh në mënyrë informale dhe nuk raportohet si shpenzim i partisë.

Në përgjithësi, partitë politike në Shqipëri kanë probleme me transparencën dhe ligjshmërinë e menaxhimit të tyre financiar. Partitë financohen në një masë të madhe në mënyrë informale. Një sërë raportimesh dhe analizash, përfshi një hulumtim nga WFD kanë nxjerrë në pah shqetësimin se shpenzimet e partive politike janë më të larta se ato që deklarohen si shpenzime vjetore operationale, por sidomos më të lartë se shpenzimet e deklaruara për financimin e fushatave zgjedhore.

### 3. Financimet private

Forumet e sigurojnë një pjesë të vogël të financave për shpenzimet e veprimtarive të tyre përmes burimeve private. Burimi më i rëndësishëm privat janë anëtarë të mirëqenë të tyre, të cilët marrin përsipër të financojnë apo sponsorizojnë ndonjë kosto operative apo veprimtari të caktuara të forumit.

Burimet private janë të kufizuara dhe të vogla në vlerë, por ato mbulojnë një pjesë të mirë të veprimtarisë së forumeve, duke qenë se në përgjithësi veprimtaria e forumeve është e kufizuar. Përfaqësuesit e forumeve raportojnë se shpenzimet për karburant apo transport, për mjedise për veprimtari publike, për kateringun në rastin e aktiviteteve, etj—mbulohen herë pas here nga anëtarë të tyre në formë private.

Forumet janë përpjekur të ngrenë fonde nga donatorë privatë, por nuk kanë patur sukses, me përjashtim të pak rasteve gjatë fushatave zgjedhore. Një studim për gratë në politikë në Shqipëri ka zbuluar se vet-financimi, që përfshin kontributet nga familja dhe të afërm, është burim kryesor për financimin e fushatave zgjedhore nga gratë. Ndërkohë që dhurimet nga biznese, miq dhe individë qytetarë është i ulët.<sup>19</sup>

Sipas po këtij raporti, “Shoqërisë shqiptare i mungon kultura e mbedhjes së fondeve politike”—thujse një e treta e vetë grave të intervistuar në studim mendonte se ngritja e fondeve është detyrë ekskluzive e partisë, ndërkohë që edhe gratë që mendojnë se përgjegjësia për ngritjen e fondeve u përket edhe atyre, në masë u shprehën se nuk dinë si mund të ngrihen fondet (vetëm 13 përqind pranuan që kanë njohuri mbi metoda për ngritjen e fondeve).

Në fakt, asnjë nga forumet nuk organizon mbledhje formale fondesh dhe nuk ka njohuri e përvojë në ngritje fondesh. Është e vërtetë, në Shqipëri ka munguar historikisht një praktikë e tillë dhe të gjithë personat e intervistuar u shprehën fare pak optimist për potencialin e ngritjes së fondeve përmes veprimtarive të kushtuara për këtë qëllim, të paktën në periudhën afatshkurtër.

Në këto kushte, është e arsyeshme të mendohet se burimet private do të vazhdojnë të jenë të kufizuara dhe forumet nuk mund të mbështeten në mënyrë të besueshme tek këto burime për të financuar një pjesë të veprimtarisë së tyre. Për më tepër, ende nuk kanë ndryshuar kushtet për formalizimin e financimeve private.

---

<sup>19</sup> Mirela Arqimandriti, Achieving Gender Equality in Party Financing in Albania, WFD (2023). *Shiko:* [https://www.wfd.org/sites/default/files/2023-05/Gender%20equality%20in%20political%20party%20financing\\_Final.pdf](https://www.wfd.org/sites/default/files/2023-05/Gender%20equality%20in%20political%20party%20financing_Final.pdf)

#### **4. Financimi nga anëtarësia**

Anëtarësia nuk ka qënë asnjëherë burim financimi—asnjë nga forumet nuk mbledh kuota anëtarësimi. Në të vërtetë, vetë partitë nuk arrijnë të mbledhin kuota të anëtarësisë. Tek të gjitha statutet partiake dhe të forumeve është sanksionuar detyrimi për të paguar kuotat e anëtarësisë, por në praktikë ky detyrim nuk është zbatuar ndonjëherë. Në tre dekadat e fundit u zhbë kultura e pagesës së këtij lloji detyrimi që zbatohet në mënyrë stikte nga partia komuniste dhe organizatat përkatëse në të shkuarën, edhe përtej organizatave politike, në përgjithësi asnjë organizatë me anëtarësi dhe detyrim kuotash, nuk e zbaton këtë detyrim aktualisht.

Përfaqësuesit partiakë dhe të forumeve që u intervistuan e pranojnë se pagesa e kuotave minimale duhet të ishte krejtësisht e mundshme dhe e thjeshtë, por ajo nuk ndodh për shkak të dobësive në menaxhimin e anëtarësisë, përfshi mungesën e regjistrave të saktë dhe kartave të anëtarësisë.

#### **5. Financime nga donatorët**

Në përgjithësi forumet nuk kanë programe, plane apo mekanizma të trajnimit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të anëtarëve për rritjen e aftësive dhe përgatitjen politike të tyre. Këto veprimtari ofrohen thuajse në mënyrë ekskluzive nga donatorët dhe partnerët e huaj të këtyre partive apo forumeve.

Në mënyrë të veçantë, forumet rinore të Partisë Socialiste dhe të Partisë Demokratike kanë marrë mbështetje të vazhdueshme nga fondacionet e partive simotra amerikane dhe evropiane apo donatorë të tjerë aktivë në fushën e demokracisë dhe shoqërisë civile në Shqipëri. Konrad Adenauer, Friedrich Ebert, NDI, IRI, WFD, Olaf Palmer, Jarl Hjalmarson, etj kanë investuar prej vitesh në forumet rinore dhe të grave të partive kryesore politike shqiptare.

Marrëdhënia me donatorët e huaj ka paraqitur vështirësi teknike, për shkak të mungesës së personalitetit juridik dhe kapaciteteve institucionale të forumeve për të hyrë në marrëveshje, marrë dhe menaxhuar fonde. Një zgjidhje për këtë situatë ka qënë menaxhimi financiar i veprimtarive nga vetë donatorët, pa përfshirjen e forumeve në administrimin e fondeve.

Në disa raste, kur forumet kanë fituar fonde apo mbështetje nga ndonjë donator i huaj që nuk mund të bënte menaxhimin e zbatimit të financimit, forumet i kanë kanalizuar fondet përmes partive përkatëse, duke përdorur llogaritë dhe infrastrukturën e saj.

Së fundmi, Partia Socialiste ka gjetur një zgjidhje alternative: çështjen e grumbullimit dhe të menaxhimit të fondeve nga donatorët ja ka ngarkuar Fondacionit “Qemal Stafa”. Fondacioni, i regjistruar si Organizatë Jo Fitimprurëse në gjykatë, është institucion partner i Partisë Socialiste, i rregulluar në statutin e PS-së (neni 64.2) si institucion që mbështet me burime financiare, njerëzore, institucionale dhe teknike veprimtarinë e partisë.

Fondacionit i është lënë edhe roli i trajnimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, përfshirë të rinjtë dhe gratë dhe në përgjithësi roli i organizimit të veprimtarive zhvilluese, në bashkëpunim apo mbështetjen e organizatave të tjera.

Aktualisht, fondacioni shërben si partneri zyrtar i të gjitha organizatave donatore dhe partnere për llogari të forumit rinor dhe të gruas. Në këtë mënyrë, PS ka zgjidhur edhe problemin e bashkëpunimeve me donatorët, organizata apo parti partnere për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe të veprimtarive të tjera zhvilluese dhe teknike.

Një formulë të ngjashme, por në një masë më të kufizuar, u përdorur pjesërisht nga Partia Demokratike përmes Fondacionit për Liri dhe Demokraci, por kjo metodë shkaktoi rivalitet dhe konflikte të brendshme midis fondacionit dhe forumit rinor dhe praktika e zhvillimit të trajnimeve me donatorët nga fondacioni për llogari të forumit u ndërpre.

## **6. Organizimi dhe marrëdhënia me partinë mëmë**

Administrimi financiar është pjesë e vet-administrimit të forumeve. Në të vërtetë, problemi i mungesës së pavarësisë financiare dhe menaxhimit financiar buron nga problemet më të thella të mungesës së pavarësisë dhe kapaciteteve institucionale vet-administruese të forumeve.

Përgjithësisht, në partitë shqiptare mungon vetëdija për nevojën e një shkalle pavarësie të forumit të gruas dhe të rinisë, si në lidhje me veprimtarinë e tyre politike, edhe në lidhje me administrimin, përfshi menaxhimin e pavarur financiar. Edhe pse teorikisht forumet janë të organizuar dhe veprojnë në bazë të statuteve dhe rregullave të tyre të brendshme, në realitet, ata veprojnë si organizata në shërbim besnik ndaj partisë dhe interesave të udhëheqjes së partisë.

Përgjithësisht, dobia e forumeve për partitë ka të bëjë thjesht me aftësinë e tyre për të mobilizuar numra dhe muskuj për tubime, protesta dhe veprimtari të tjera publike si dhe për mobilizim të anëtarësisë dhe votuesve në fushatat zgjedhore: forumet janë mbi të gjitha burim krahë pune dhe muskuj për mitingje dhe zgjedhje.

Forumet rinore dhe të gruas nuk kanë pjesëmarrje apo rol të qenësishëm në diskutimet politike brenda partisë apo diskutimet publike për çështje të politikave publike në lidhje me grupet që ato përfaqësojnë. Në përgjithësi, drejtuesit dhe anëtarët e këtyre forumeve përsërisin dhe përcjellin në mënyre besnike në publik tezat, qendrimet dhe pikat e diskutimit të vetë partisë, pa patur vetë ndikim në formulimin e tyre. I pakët është edhe ndikimi dhe qasja e forumeve në vendim-marrje partiake—forumet kanë pak hapësirë institucionale për të ndikuar qendrimet apo vendime politike të partisë.

Nga pikëpamja institucionale forumet janë të organizuara në mënyrë territoriale duke imituar organizimin e partisë mëmë, veçanërisht në rastin e forumeve të PD-së dhe të PL-së. Rasti më ekstrem është ai forumit rinor të PD-së, i cili ka imituar në çdo detaj strukturën e partisë në të gjitha nivelet, duke krijuar një ngrehinë organizative tejet të fryrë me këshilla, kryesi,

sekretariate, departmente—të gjitha me numër të madh anëtarësh, edhe pse funksioni i kësaj strukturave është i panevojshëm dhe i papërshtatshëm për një forum rinor.

Këto struktura të fryra krijojnë një grupim të mbyllur në krye të forumeve, të panevojshëm për funksionimin e tyre dhe me ndikim negative në harmoninë e brendshme dhe në dinamikat institucionale të tyre.

Mungesa e hapjes së kësaj elite drejtuese dhe mospërqafimi i teknologjive moderne në komunikim është një tjetër pengesë për ndikimin e forumeve dhe për izolimin e tyre nga grupet që ato synojnë të përfaqësojnë dhe mbështesin. Për ilustrim, statutet, vendimet dhe dokumentat e tjerë të forumeve nuk janë publikë dhe anëtarët e thjeshtë nuk kanë qasje tek to. Regjistrat e anëtarësisë janë përgjithësisht të papërditësuar dhe mbahen në mënyrë joelektronike, sikurse nuk janë publike listat e votuesve në garat e brendshme. Asnjë nga forumet nuk ka faqe në internet dhe as llogari zyrtare në rrjetet sociale. Komunikimi përmes këtyre mediave moderne është i rastësishëm dhe sipërfaqësor, duke kufizuar shumë ndikimin publik të këtyre forumeve.

E mangët është sidomos pjesëmarrja dhe ndikimi i forumeve të grave dhe të rinisë në veprimtarinë lokale të partive, në nivelin e bashkive ose njësive administrative. Në territor, burimet financiare të forumeve janë thuajse inekzistente dhe veprimtaria e tyre në përgjithësi është e mangët, jashtë mobilizimit për fushata dhe për mitingje.

Në fakt, si PD-ja ashtu edhe PL-ja e kanë zvogëluar hapësirën kushtuar rinisë dhe grave vetëm tek forumet, duke lënë pak hapësirë për politika për rininë dhe gruan në vendim-marrjen dhe veprimtarinë e përditshme partiake.

Ndërsa PS ka përqaftuar një qasje të ndryshme dhe ka krijuar një strukturë të veçantë organizimi nga forumet tipike, pjesërisht për të shmangur problemin e segregimit të rinisë dhe grave brenda forumeve përkatëse. Kreu më poshtë shtjellon më në detaje këtë organizim të forumeve socialiste.

## **7. Organizimi i organizatave partnere në Partinë Socialiste dhe politika e kuotave**

Ndonëse janë organizata formale të sanksionuara në statutin e Partisë Socialiste (nenet 63 dhe 64), në praktikë Forumi Rinor Eurosociaist i Shqipërisë dhe Forumi i Gruas Socialiste të Shqipërisë, kanë pushuar së vepruari si institucione, por funksionet e tyre janë shkruirë dhe integruar në të gjithë strukturën e Partisë Socialiste.

Një nga ndryshimet themelore që Kryetari i PS-së ka sjellë në organizimin e brendshëm të partisë në dekadën e fundit, ka qënë organizimi i integruar në një strukturë të vetme me organizim territorial i të gjitha institucioneve të partisë, përfshi organizatat partnere. Sipas këtij modeli, në çdo zonë elektorale, e gjithë partia vepron si një trupë e vetme — të gjithë anëtarët dhe aktivistët e saj dhe të gjitha burimet e saj mobilizohen në mënyrë të centralizuar nën drejtimin e udhëheqësit të caktuar partiak për atë zonë elektorale.

Puna me të rinjtë, qofshin anëtarë, aktivistë apo mbështetës të PS-së, nuk organizohet në kuadër të forumit, por brenda strukturës së partisë dhe në bazë të strategjisë, planit të punës së partisë për zonën. E njejta gjë është e vërtetë edhe për gratë.

Për të organizuar punën me të rinjtë apo gratë si grupime shoqërore, Partia Socialiste ka krijuar pozicionet e Sekretares për Çështjet e Gruas dhe të Sekretarit për Digjitalizimin dhe Rininë. Faktikisht, këta sekretarë ushtrojnë të gjitha përgjegjësitë që do të kishin përkatësisht drejtueset e forumit të gruas dhe të rinisë. Për ta forcuar nga ana organizative, PS ka krijuar pozicionin e koordinatorit për rininë dhe për gruan në të gjitha organizatat socialiste, veçanërisht në nivel dege, të cilët koordinojnë punën e partisë me gratë dhe të rinjtë. Këta koordinatorë i raportojnë drejtuesit rajonal dhe sekretarit përkatës të partisë.

Llogjika pas këtij reformimi të punës me të rinjtë dhe me gratë ka të bëjë me integrimin direkt në parti të të rinjve dhe të grave pa qenë nevoja për të krijuar struktura të posaçme të cilat mund të krijojnë segregim. Sipas këtij arsyetimi, qëllimi i forumit të gruas është që të mbështesë karrierën e grave në parti dhe nëse vetë partia e ka prioritet politik dhe praktikë të përdishme barazinë gjinore, duke afruar, nxitur dhe mbështetur gratë nga çdo fushë apo grup shoqëror, atëherë forumi i gruas bëhet i panevojshëm formalisht. Madje forumi i gruas mund të ngushtojë kanalet e prurjes së grave në parti: përkundrazi, partia duhet të jetë e hapur për çdo prurje direkte individuale apo nga grupe të ndryshme interesi apo të mbështetësve dhe jo vetëm nga forumi i grave. Forumi krijon barrë dhe barriera të panevojshme për gratë që nuk janë pjesë e tij, por duan të afrohen me partinë. Veçanërisht ai bëhet problem pasi krijon një tjetër institucion në të cilin mund të sundojnë apo përplasen ambicje dhe interesa dhe të sundojë konflikti, favorizime, etj.

Për të balancuar këtë zhvlerësim të forumit të gruas, por edhe për të arritur në mënyrë me efikase qëllimin kryesor të vetë ekzistencës së forumit të grave—përfshirjen e grave në politikë dhe forcimin e barazisë gjinore—Partia Socialiste ka zyrtarizuar dhe po zbaton një politikë të barazisë absolute gjinore në të gjithë strukturën drejtuese të partisë. Sipas kësaj politike, drejtimi i strukturave partiake në të gjitha nivelet, nga organizata bazë socialiste deri në drejtimin e degëve, realizohet si bashkëkryesim midis një burri dhe një gruaje.

Aktualisht, në një pjesë të madhe të organizatave socialiste është arritur në praktikë, në të gjitha degët, organizimi me bashkëkryesim, por kjo ka ndodhur vetëm pjesërisht në organizatat e tjera socialiste në nivele më të ulta. Partia Socialiste është e vendosur që ta zbatojë bashkëkryesimin në të gjitha organizatat socialiste në të gjitha nivelet.

Duke shtuar edhe dominimin e grave në postet qeveritare (10 gra ministre nga 17) dhe praninë e tyre të konsiderueshme në drejtimin e Partisë Socialiste (3 nga 7 sekretarë janë gra) dhe në grupin parlamentar (30 nga 74) mund të thuhet se modeli i integritit përmes kushtëzimit të barazisë gjinore në poste drejtuese ka sjellë rezultate mbresëlënëse.

Ndërsa PS-ja dallohet për praktikën e saj të konsoliduar dhe të suksesshme me politikën gjinore, politika e kuotave është përqaftuar nga të gjitha partitë politike, përfshi PD-në dhe PL-në. Në statutin e PD-së (neni 58/3) është sanksionuar se përfaqësimi i LDG-së në

forumet drejtuse partiake respekton standardin minimal të parashikuar nga ligji elektoral për përfaqësimin e grave në listat e kandidatëve. Kjo do të thotë që aktualisht 30 për qind e përbërjes së të gjitha forumeve drejtuese të PD-së në të gjitha nivelet duhet të jenë gra.

PD gjithashtu vendos edhe kuota për përfaqësimin e të rinjve, të cilëve statuti u garanton 5 për qind të të zgjedhurve në këshillat vendorë, si dhe me 10 për qind të listës së kandidatëve për në Kuvendin e Shqipërisë.

Partia e Lirisë (PL) e sanksionon në statut barazinë gjinore dhe për të garantuar këtë barazi, Statuti përcakton se në të gjitha konkurimet për në forumet drejtuese të PL-së në të gjitha nivelet LGI konkuron me listë të veçantë. Statut i PL-së sanksionon se 30 për qind e të gjitha kandidatëve për forumet drejtuese duhet të plotësohen nga anëtarë të LRI-së të cilët garojnë me listë të veçantë për të garantuar këtë kuotë.

Tabloja e mësipërme dëshmon se të treja partitë kanë më shumë preferencë të forcojnë përfshirjen dhe përfaqësimin e gruas me anë të politikës së kuotave se sa përmes mbështetjes dhe fuqizimit të forumeve të grave.



## IV. GJETJE DHE PËRFUNDIME

### Gjetje

Forumet rinore janë të pazhvilluar institucionalisht dhe veprojnë më shumë si degë apo strukturë e brendshme partiake, se sa si organizata të mirëfillta autonome. Asnjë nga forumet nuk është i regjistruar në gjykatë dhe nuk është person juridik. Asnjë forum nuk është regjistruar si subjekt fiskal dhe asnjë nuk mund të veprojë si palë formale në marrëdhënie apo transaksione me palë të treta.

Asnjë nga forumet nuk ka struktura, praktika apo rregulla formale të menaxhimit dhe nuk kryen planifikim, zbatim dhe raportim financiar. Përfshirja e forumeve në marrëdhënie ekonomike, kryhet përgjithësisht në mënyrë informale.

Burimi kryesor financiar i forumeve janë partitë përkatëse. Financimi i partive është kryesisht financim indirekt që mundëson një minimum të veprimtarisë operacionale dhe veprimtarive të tjera të forumeve. Ky financim bëhet rast pas rasti—asnjë nga partitë nuk planifikon apo cakton buxhet vjetor për forumet.

Forumet nuk ngrenë fonde nga kuotat e anëtarësisë dhe kanë aftësi të kufizuara në ngritjen e fondeve nga burime private.

Donatorët e huaj mbeten burimi kryesor i financimit të veprimtarive për edukimin dhe rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të forumeve dhe në përgjithësi të të rinjve dhe grave në vend.

Veprimtaria e forumeve është e kufizuar kryesisht në mobilizimin të bazës së tyre në mbështetje të partisë, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Forumet kanë pak ndikim në qendrimet e partisë dhe në vendim-marrjen e tyre. Mendësia e partive, por edhe vetë forumeve është se forumet duhet t'i shërbejnë partisë—ka pak vetëdije për një rol më të gjërë politik dhe demokratik të forumeve dhe veçanërisht për rolin që ato duhet të luajnë në mbështetje të interesave të grupeve që ato përfaqësojnë, të grave dhe të rinjve.

Veprimtaritë për zhvillimin e kapaciteteve, aftësimin e anëtarëve, advokacinë dhe ndikimin e politikave publike nga ana e forumeve janë të rastësishme dhe të kufizuara.

Praktikisht forumet rinore dhe te gruas së PS-së kanë pushuar së vepruari formalisht dhe janë integruar në mënyrë të qenësishme brenda strukturës partiake dhe veprojnë krejtësisht nën drejtimin dhe menaxhimin partiak.

Forumet rinore të PD-së dhe të PL-së kanë kaluar faza krize të brendshme vitet e fundit.

Gratë në përgjithësi dhe gratë në forumet e grave të partive kanë përfituar nga kuotat gjinore dhe masat ligjore për zbatimin e tyre në përfaqësimin parlamentar. Ndërsa, të gjitha partitë kanë politika të brendshme të barazisë gjinore, vetëm Partia Socialiste ka arritur në praktikë të zbatojë dhe arrijë një nivel të kënaqshëm të barazisë gjinore.

Partitë politike kanë burime të kufizuara financiare, veçanërisht burime të ligjshme apo formale. Një pjesë e financimit të tyre, veçanërisht në fushata zgjedhore, bëhet në mënyrë informale dhe pa transparencë. Financimi i partive politike mbetet një nga problemet më shqetësuese në vend.

## Përfundime

Duke patur parasysh këtë gjendje institucionale të organizatave partnere, masat për rritjen e financimit dhe forcimin e menaxhimit financiar të forumeve nuk mund të jenë të shkëputura dhe nuk mund të prodhojnë rezultate, nëse nuk gërshetohen dhe nuk përfshihen në përpjekjet më të gjëra për fuqizimin e identitetit ligjor dhe institucional të këtyre forumeve—çfarë është parakusht i domosdoshëm për të arritur vet-menaxhimin financiar.

Në hartimin e strategjive për përmirësimin e financimit të organizatave partnere dhe të propozimeve për ndryshime ligjore e rregullatore është e nevojshme të merren parasysh dinamikat strukturore që ekzistojnë midis partisë dhe forumeve përkatëse. Ajo që është më e rëndësishme është të kuptohet se drejtuesit e tre partive nuk janë të hapur për rritjen e autonomisë dhe autoritetit të forumeve, prandaj duhen nxitur reformat e brendshme.

Nga ky këndvështrim, është e qartë se një ndërhyrje e thjeshtë në kuadrin ligjor të partive politike apo në statutet dhe rregulloret e brendshme të partive apo forumeve nuk mund të arrijë rezultatet e dëshiruara. Masat për rritjen e financimit dhe forcimin e menaxhimit financiar të forumeve duhet të jenë të tilla që të nxisin, motivojnë apo detyrojnë partitë dhe forumet për të marrë masa për përmirësimin dhe forcimin institucional të forumeve dhe në përgjithësi forcimin e autonomisë së tyre përballë partisë dhe më gjërë.

Mbi të gjitha duhet pranuar se pushimi i ekzistencës *de facto* të forumeve të rinisë dhe të gruas në Partinë Socialiste dhe vullneti i fortë i kryeministrit Rama për të braktisur përfundimisht modelin e forumeve të posaçme që veprojnë jashtë strukturës partiake në favor të thithjes dhe integritit të anëtarësisë rinore dhe të grave dhe të interesave të tyre brenda parties, kushtëzon në një masë të madhe hapësirën për ndryshime ligjore dhe rregullatore për të ndërmarrë masa që forcojnë autonominë dhe pavarësinë e forumeve nga partitë përkatëse.

Duhet pranuar gjithashtu që interesi i PD-së dhe PL-së për të pranuar zgjidhje që transferojnë fonde publike nga funksionet e përditshme partiake tek forumet e rinisë dhe të gruas është i pakët.

Së fundmi, duhet theksuar se forumet rinore apo organizatat rinore të përshira në veprimtari për aftësimin politik, përmirësimin e kulturës politike dhe në përgjithësi për përhapjen e vlerave demokratike, mund të luajnë një rol të madh për krijimin e brezave të rinj me mendësi perëndimore politike dhe shoqërore. Për këtë arsye, anagzhimi i forumeve në veprimtari edukuese dhe formuese më të shpeshta, me shtrirje më të madhe dhe me cilësi më të lartë është shërbim përtej interesave partiake dhe si i tillë duhet mbështetur përtej programeve dhe linjave të mbështetjes për partitë politike.

Nëse duhet që forumet rinore dhe të gruas ta përmbushin këtë mision, por në veçanti të të luajnë rol në nxitjen e pjesëmarrjes në politikë të të rinjve dhe të grave dhe mbrojtjen e nxitjen e interesave të tyre, ato duhet të kenë të garantuara burime bazë dhe të qendrueshme financimi, të cilat duhet t'i menaxhojnë në mënyrë të pavarur.

Në këto kushte dhe me këtë arsyetim, përfundimi i natyrshëm është që forumet rinore duhet të mbështeten me fonde publike. Në periudhën afatshkrutër këto fonde duhet të përfitohen jashtë kanaleve partiake dhe të menaxhohen pa trysinë apo ndërhyrjen e partisë.

Ndihma shtetërore mund të luajë një rol të madh për të ndikuar indirekt në kapërcimin e pengesave dhe në fuqizimin e forumeve rinore dhe të gruas, jo vetëm, duke u dhënë atyre më shumë pavarësi financiare, më shumë aftësi për të zhvilluar programet e tyre të veprimtarisë, më shumë liri për vet-administrimin, por edhe duke i nxitur ato larg frymës konfliktuale dhe polarizuese partiake drejt një mendësie së bashkë-ekzistencës, bashkëpunimit konstruktiv dhe konkurrencës së ndershme.

Krahas ndihmës shtetërore, një rol të madh për financimin dhe për rrjedhojë zhvillimin e forumeve rinore dhe të gruas mund të japin donatorët dhe partnerët e huaj. Ata mund të ndihmojnë vecanërisht për promovimin dhe fuqizimin e të drejtave, pjesëmarrjes dhe karrierës politike të të rinjve dhe grave dhe në përmirësimin e politikave rinore dhe gjinore, përtej dallimeve partiake.

Duke patur parasysh se fondet që angazhojnë donatorët e huaj—për forcimin e partive politike, forumeve partiake dhe të demokracisë e mirëqeverisjes në përgjithësi —janë në total më të mëdha se fondet vendase për këtë qëllim, donatorët mund të arrijnë rrisin ndikimin e ndihmës së tyre, nëse koordinojnë dhe bashkëpunojnë për të mbështetur programe, projekte dhe skema financimi të përbashkëta. Minimalisht do të ishte e dobishme që, në përcaktimin e formave të financimit publik si dhe në hartimin e programeve të tyre të ndihmës, donatorët të kenë prioritet objektivat për rritjen e pavarësisë, aftësive organizative dhe vlerave demokratike politike, të tilla si bashkëpunimi, toleranca, mirëkuptimi, të forumeve partiake dhe në përgjithësi organizatat që veprojnë në këtë drejtim.

Së fundmi, duhet theksuar se skemat që motivojnë dhe stimulojnë mund të jenë më efikase dhe më produktive se sa masat kushtëzuese dhe shtrënguese për arritjen e objektivave të hapjes, demokratizimit dhe forcimit të pavarësisë të organizatave partnere partiake.

## V. REKOMANDIME

Periudha e tanishme është një periudhë e papërshtatshme për ndryshme të thella të forumeve rinore dhe të grave. Jemi rreth 10 muaj para zgjedhjeve dhe qëllimi kryesor i partive politike tashmë është uniteti, disiplina dhe funksionimi hierarkik dhe mobilizimi i votuesve — të gjitha në funksion të fushatës zgjedhore.

Në këtë periudhë asnjë nga partitë nuk ka kohën, përqendrimin dhe interesin për të riparë organizimin apo për të ndërmarrë hapa në drejtim të pavarësisë së forumeve.

Në mënyrë të veçantë, Partia Demokratike dhe Partia e Lirisë janë në mes të përpjekjeve për konsolidimin dhe bashkimin e anëtarëve, mbështetësve dhe drejtuesve të partisë në të gjitha nivelet, pas përçarjeve dhe përplasjeve të brendshme. Për më tepër, drejtuesit e këtyre dy forcave kanë prioritet sigurimin e harmonisë dhe të balancave të brendshme dhe janë të papërgatitur për të ndërmarrë hapa që mund të hapin vatra të reja debate apo përplasjesh të brendshme.

Fushata zgjedhore do të sjellë gjithashtu, me shumë gjasa, prurje të reja në nivelin e lartë të këtyre partive, si në listën e deputetëve ashtu edhe kooptimin në nivele të larta drejtuese—si rrjedhojë e proceseve të rifreskimit të zakonshëm të imazhit të partive politike në prag fushatash.

Pas zgjedhjeve të vitit 2025, me shumë gjasa partitë kryesore do të rifuten në procese reflektimi dhe riorganizimi të brendshëm, në varësi të rezultateve të zgjedhjeve, veçanërisht mes partive opozitare dhe ky mund të jetë një moment i mirë për të propozuar ndryshime dhe përmirësime për të fuqizuar direkt po indirekt financimin dhe menaxhimin financiar të forumeve rinore dhe të gruas.

Për këtë arsye sugjerimi është që periudha një vjecare përpara të përdoret për të diskutuar dhe përgatitur një paketë propozimesh konkrete në këtë drejtim të cilat të jenë gati të diskutohen me udhëheqësit politikë partiake dhe parlametin dhe qeverinë e re pas zgjedhjeve.

Disa nga propozimet që mund të përpunohen më tej dhe të diskutohen gjatë kësaj periudhe, bazuar mbi shqyrtimin e modeleve evropiane dhe gjendjes lokale, përkthehen në vija të përgjithshme më poshtë.

## 1. Hapja e programeve të mbështetjes së shoqërisë civile për organizatat partnere partiake

Propozimi (sipas modelit finlandez):

- Ndryshimi i ligjit të rinisë për të klasifikuar si organizata rinore edhe forumet partiake.
- Hapja e programit të Agjencisë së Mbështetjes së Shoqërisë Civile, të Agjencisë së Rinisë dhe të Ministrisë së Rinisë për mbështetjen e forumeve rinore, nëse ato plotësojnë kriteret ligjore dhe standardet e tjera të përcaktuara.
- Përcaktimi i disa kufizimeve dhe kriterëve specifike për projektet e propozuar nga forumet rinore, për të shmangur keqpërdorimin partiak të fondeve publike.
- Krijimi i disa stimuljve të veçantë për favorizimin e projekteve të përbashkëta ndërpartiake të forumeve rinore të partive të ndryshme (në linjë me propozimin pasues).

Qeveria shqiptare afron një sërë skemash të mbështetjes të shoqërisë civile në përgjithësi dhe të organizatave rinore në veçanti.

Këto skema duhet të hapen edhe për mbështetjen e forumeve rinore të partive politike, duke i vendosur ata në të njëjtin plan me organizatat rinore, sipas përcaktimeve të Ligjit për Rininë.

Nga ana sasiore, këto financime mund të jenë një burim i rëndësishëm, i qendrueshëm dhe i konsiderueshëm për forumet rinore. Vetëm Agjencia e Shoqërisë Civile afron mbi një milionë eur financime çdo vit—ndërkohë që burimet e tjera në nivelin qendror dhe lokal, veçanërisht në Tiranë, gati e trefishojnë këtë shumë.

Gjithashtu, ky lloj financimi ofron një bazë të sigurtë për vet-menaxhimin financiar, administrativ dhe rritjen e pavarësisë së organizatave partnere, pasi kriteret e lëvrimit, zbatimit dhe raportimit të fondeve e bëjnë të domosdoshëm menaxhimin financiar nga vetë forumet.

Nga ana tjetër qasja tek fondet për shoqërinë civile do t'i nxisë apo stimulojë forumet rinore (partitë politike) që të regjistrohen si Organizata Jo Fitimprurëse (shoqata) dhe në organet fiskale duke mundësuar kështu formalizmin e tyre. Ligji për Rininë përcakton se 'organizatë për të rinjtë' apo 'organizatë rinore' janë vetëm personat juridikë jo fitimprurës të regjistruar në bazë të ligjit për Organizatat Jo Fitimprurëse—përfitimi nga skemat e financimit të organizatave rinore e kanë të detyrueshëm regjistrimin në databazën e organizatave rinore. Po ashtu përfitimi nga fonde të tjera shtetërore mund të bëhet vetëm nëse aplikuesit janë persona juridikë.

Formalizimi u jep qasje (më të madhe) këtyre forumeve edhe në fonde nga burime të tjera jo-qeveritare, veçanërisht nga donatorët e huaj.

Nga ana tjetër, qasja në këto fonde publike për shoqërinë civile ndaj forumeve rinore apo të gruas mund të sillnin një sërë përparësish dhe efektesh pozitive:

- a) Mund t'i orientojë organizatat më shumë drejt qëllimit themelor të tyre, të edukimit dhe formimit politik dhe qytetar të anëtarëve të tyre, duke përmirësuar kështu cilësinë e aktivitetit aftësi-formues të këtyre forumeve.
- b) Mund të përmirësojë e cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarisë së forumeve dhe për rrjedhojë të ndikimit të tyre në bazën e tyre dhe në përgjithësi në shoqëri.
- c) Mund të përmirësojë efikasitetin në përdorimin e fondeve dhe krijojë përvojë në menxhimin financiar të këtyre organizatave.
- d) Mund të rrisë mundësitë bashkëpunimit me organizatave të tjera të shoqërisë civile apo edhe forume të partive të tjera.

Një variant i hapjes së progameve/skemave të mbështetjes me fonde publike të shoqërisë civile/organizatave rinore, mund të jetë caktimi brenda këtyre skemave i një fondi të dedikuar vetëm për mbështetjen e forumeve partiake rinore apo të fondacioneve partiake.

Një mekanizëm i tillë mundëson planifikim më të mirë të fondeve publike për organizatat rinore partiake, por edhe lejon vendosjen e kriterëve më specifike për përfitimin nga fondet publike prej këtyre organizatave.

## **2. Nxitja e krijimit të një këshilli ndërpartiak koordinues dhe programeve të përbashkëta**

Propozimi (mbështetur në modelin e EDYN):

- a) Themelimi i një strukture ombrellë apo një këshill ndërpartiak me përfaqësues nga të tre forumet i cili ka për qëllim:
  - hartimin, aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta midis forumeve, përfshi në linjat e financimit që kërkojnë aplikime në bashkëpunim mes dy ose më shumë partnerëve apo organizatave.
  - kordinimin dhe lehtësimin e projekteve të donatorëve që targetojnë pjesëmarrjen e të gjitha forumeve.
- b) Krijimi i një programi apo linje programore për mbështetjen e projekteve të përbashkëta midis dy ose më shumë forumeve rinore. Linja mund të krijohet në kuadër të progameve të donatorëve, veçanërisht donatorëve të mëdhenj si Bashkimi Europian/Delegacioni i BE-së; Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Agjencia Kombëtare e Rinisë, etj.
- c) Një projekt ambicioz që mund të eksplorohet si konkretizim i propozimit më sipër është krijimi i një akademie të përhershme politike ndërpartiake, që ofron trajnim për përfaqësuesit partiakë të të gjitha bindjeve, përfshi trajnimin dhe aftësimin e forumeve rinore dhe të gruas. Akademia mund të jetë bashkëfinansim i qeverisë dhe donatorëve.
- d) Krijimi i një grupi konsultativ të donatorëve për: 1) të mbështetur këshillin ndërpartiak, dhe 2) për të koordinuar apo harmonizuar fondet dhe programet individuale të tyre, me qëllim realizimin e projekteve dhe veprimtarive të

përbashkëta ndërpartiake, veçanërisht në fushën e aftësisimit dhe formimit politik (trajnime, seminare, mentorime, etj), të advokacisë dhe të kulturës politike.

Propozimet e mësipërme mund të nxisin bashkëpunimin ndërpartiak dhe përmirësojnë aksesin në burimeve financiare të forumeve rinore edhe në mungesë të formalizimit të bashkëpunimit mes tyre në formën e këshillit koordinues të propozuar më sipër.

Qasjet shumë-partiake që sjellin bashkarisht nga parti të ndryshme, së bashku mund të ndihmojnë për të ulur polarizimin dhe për të ndihmuar në zhvillimin e formave konstruktive të debatit politik dhe garës politike.

Ato mund të ndihmojnë gjithashtu për krijimin e njohjeve dhe marrëdhënieve personale për të ndërtuar një politikë më pak polarizuese më konstruktive dhe veçanërisht për të nxitur një frymë kombëtare të përbashkët në trajtimin e çështjeve të rëndësishme.

Përveç përfitimeve të tjera ato mund të shmangin pengesat që shpesh herë forumet rinore hasin nga dejtuesit më të vjetër të partisë për të mos bashkëpunuar me kundërshtarët politikë, pra me të rinjtë dhe forumet rinore të partive të tjera.

Ky bashkëpunim dhe financim i koordinuar mund të përdoret fare mirë për formimin e e të rinjve në fushën e zgjedhjeve (trajnimi për kandidatë, menaxherë fushatash, etj), për komunikim publik (për të folurën publike, për debat, për zëdhënës politik, etj), për bazat e politikave publike (bazat e politik-bërjes, analiza e politikave publike, etj).

### **3. Nxitja e barazisë gjinore përmes stimujve financiarë**

Propozim (sipas modelit kroat):

Vendosja e stimujve monetarë për përfaqësimin e grave në Kuvend. Një propozim ilustrues mund të jetë: shpërblimi i një partie me një shtesë prej 30 përqind të fondit vjetor për çdo 15 për qind të vendeve në parlament të mbajtura nga gra. Pra, për 15 për qindshin e parë të vendeve të veta të mbajtura nga gra, merr 30 përqind shtesë fondesh vjetore për çdo vit deri në zgjedhjet pasardhëse, nëse arrin 30 përqind të deputeteve merr 60 për qind shtesë, nëse arrin 45 përqind deputete merr 90 përqind fonde shtesë.

Ndëshkimi aktual për mos respektimin e kuotës për kandidatet gra në listat zgjedhore nuk është shumë efikas për të arritur barazinë gjinore në parlament, pasi partitë e respektojnë atë në mënyrë dogmatike, duke vendosur një grua në çdo tre kandidata në listat rajonale, por që në shumicën e rasteve nuk kanë asnjë mundësi të zgjidhen. Ndërkohë gjobat për mos plotësimin e këtij kushti janë të papërfillshme për t'u paguar nga partitë.

Nga ana tjetër fondet shtesë mund të kushtëzohen që të përdoren nga grupi parlamentar apo deputetët e partisë në mbështetje të veprimtarisë së tyre të përditshme. Një kushtëzim më specifik mund të jetë që këto fonde shtesë t'i shkojnë direkt grupit parlamentar dhe jo partisë, duke garantuar që gratë do të përfitojnë direkt prej tyre.

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është institucion publik i Mbretërisë së Bashkuar që mbështet demokracinë në të gjithë botën.

Me shtrirje ndërkombëtare, WFD punon me parlamentet, partitë politike, grupet e shoqërisë civile dhe me zgjedhjet që të ndihmojë t'i bëjë sistemet politike të shteteve më të drejta, më përfshirëse dhe llogaridhënëse.



[www.wfd.org](http://www.wfd.org)



[@WFD\\_Democracy](https://twitter.com/WFD_Democracy)



[@WestminsterFoundation](https://www.facebook.com/WestminsterFoundation)



Fondacioni Westminster për Demokraci është institucion ekzekutiv publik i mbështetur nga Zyra për Marrëdhëniet me Jashtë, Komunellthin dhe Zhvillimin.

